LIGJ
Nr. 132/2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9695, DATË 19.3.2007, "PËR PROCEDURAT E BIRËSIMIT DHE KOMITETIN SHQIPTAR TË BIRËSIMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9695, datë 19.3.2007, "Për proce-durat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 10 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Të ketë arsimin e lartë në shkenca juridike, niveli minimal i diplomës "Master shkencor".

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

"3. Të ketë përvojë pune prej jo më pak se 5 vjetësh në fushën e të drejtave të fëmijëve.".

Neni 2

Në nenin 24, pas shkronjës "b" shtohet shkronja "c" me këtë përmbajtje:

"c) afati i konsiderimit i përshtatshëm, i aplikantit birësues, është 2 vjet nga data e dhënies së vendimit nga Këshilli Drejtues. Në rastet kur ky afat përfundon, sekretariati ekzekutiv i Komitetit Shqiptar të Birësimit i kërkon aplikantit rifreskimin e dokumentacionit dhe bën rivlerësim të situatës aktuale të tij, duke paraqitur edhe propozimet konkrete për rinovim të afatit të përshtatshmërisë ose heqje të tij. Rishqyrtimi i dosjes dhe kushteve të aplikantit bëhet brenda 2 muajve nga dita e përfundimit të afatit të përshtatshmërisë.".

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.12.2015

Shpallur me dekretin nr. 9366, datë 17.12.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani